



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, PRONAVE DHE TRANSPORTIT

## RELACION

### MBI MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA NË FAVOR TË SHOQËRISË SHELL UPSTREAM SHQIPËRI TË PASURIVE NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT

#### Të nderuar Këshilltarë !

Bashkia Berat , nisur nga kërkesa nr.169,datë 18.03.2021 e Shoqërisë Shell Upstream Shqipëri, për marrjen me qira të disa pasurive të paluajtshme, paraqet këtë relacion “Për nisjen e procedurave të Qirasë të disa pasurive në pronësi dhe/ose përdorim të Bashkisë Berat në favor të Shell Upstream Shqipëri.

Shell Upstream Albania B.V. (SUA) është Operatori i Kontratës së Ndarjes së Prodhimit (PSC) të Bllokut 2-3 Shqipëri në tokë. Shell planifikon të kryejë shpimin e pusit (naftë dhe gaz natyror) të vlerësimit të Shpirag-5; 4 në Bllokun 2-3 në rajonin e Beratit, pranë Njësisë Administrative Sinjë të Bashkisë Berat.


Nga verifikimet e kryera në terren nga specialistet Shell Upstream Shqipëri, rezulton se preket disa pasuri të paluajtshme në pronësi dhe/ose përdorim të Bashkisë Berat, e llojit kullotë me sipërfaqe totale prej 257 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë) m<sup>2</sup>, e llojit rrugë, kanale dhe përrua me sipërfaqe 8,675 (tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup> dhe të llojit arë me sipërfaqe 570 (pesëqind e shtatëdhjetë) m<sup>2</sup> evidentuar në listën bashkëlidhur projektvendimit, për të cilën, për nevoja të projektit, Investitori i Projektit kërkon të marrë me qira për një periudhë 24 (njëzetë e katër muaj), nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së Qirasë. Për pasuritë e llojit rrugë, kanale dhe përrua, Shoqëria Shell Upstream Shqipëri për zbatimin e projektit kërkon me qira të pasurive që preken nga projekti , konform kuadrit ligjor në fuqi.

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” Neni 8 pika 1.2 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” nën-pika “a” dhe “c” si dhe VKM nr 433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish - Komunave/Bashkive, pika 4 si dhe të VKM Nr 1064 datë 22.12.2020 “Për disa ndryshime në VKM Nr 391 datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” Shtojca 9 si dhe VKM nr 834 datë 21.11.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat, të Qarkut të Beratit” si dhe Ligjit Nr 24 datë 9.3.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit” si dhe VKM Nr 54 datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Kreu III pika 2. Në një gjykim të përgjithshëm këto lloj investimesh janë oportunitete për Bashkinë në funksion të rritjes së mundësisë së punësimit dhe në aspektin rajonal dhe kombëtar i japin vendit një rol të rëndësishëm në sektorin hidrokarbureve .

Bashkëlidhur do të gjeni listën e pasurive që preken nga gjurma e projektit të Shoqërisë Shell Upstream Shqipëri kërkon ti marrë me qira , për një periudhë dy vjeçare .  
Për sa më sipër, kërkojmë nga Ju miratimin e dhënies me qira të listës së pasurive në pronësi të Bashkisë Berat në favor të Shell Upstream Shqipëri”.

Drejtori

Erlin Kuçi



Daftar Pasuqwe me guraqwe fawote Shelli yjstam (SUA)														
No	Bashkia	Njesta Administrative	Fshati	ZK	Nr Parcelle	Vol	Eage	Lloji Pasurise	Proun/Perdonues	Sip/Totalite Parcelles	Sip/Orta (m)	Cmimi (lek/m)	Vlera Qira (lek/m)	Vlera Totale (lek/m)
1	Beral	Sinjë	Mbreshan	2634	349	7	241	Kullote	Bashkia Beral	1,262,244	246	128	31,488	62,976
2	Beral	Sinjë	Mbreshan	2634	16/8			Kanal	Bashkia Beral	473	473	128	60,544	121,088
3	Beral	Sinjë	Mbreshan	2634	17/2	1	85	Kullote	Bashkia Beral	10,000	11	128	1,408	2,816
4	Beral	Sinjë	Mbreshan	2634	27/8	1	123	Rugë	Bashkia Beral	5,950	175	600	105,000	210,000
5	Beral	Sinjë	Mbreshan	2634	65	2	203	Rugë	Bashkia Beral	38,700	1,672	600	1,003,200	2,006,400
6	Beral	Sinjë	Mbreshan	2634	64/16	2	200	Kanal	Bashkia Beral	1,950	1,793	128	229,504	459,008
7	Beral	Sinjë	Mbreshan	2634	64/18	2	202		Bashkia Beral	5,400	4,562	128	583,936	1,167,872
8	Beral	Sinjë	Mbreshan	2635	16/27	7	122	Arë	Bashkia Beral	570	570	128	72,960	145,920
	<b>Totall</b>										<b>9,502</b>		<b>2,088,040</b>	<b>4,176,080</b>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2021

**MBI MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA NË FAVOR TË SHOQËRISË SHELL UPSTREAM  
SHQIPËRI TË PASURISË NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT**

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” Neni 9 pika 1.2 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” nën-pika “a” dhe “c”, Neni 27 pika 1,2,5, Neni 54 pika ‘e’ dhe Neni 55 pika 4 si dhe ligjit 9693/2007 “Për fondin kullor” të ndryshuar dhe VKM nr 433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish - Komunave/Bashkive, pika 4 si dhe të VKM Nr 1064 datë 22.12.2020 “Për disa ndryshime në VKM Nr 391 datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” Shtojca 9”, VKM Nr 54 datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Kreu III pika 2. si dhe VKM nr 834 datë 21.11.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat, të Qarkut të Beratit” si dhe Ligjit Nr 24 datë 9.3.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë dhënien me qira në favor të Shoqërisë Shell Upstream Shqipëri të tetë pasurive të llojit kullotë, arë dhe kanal, në pronësi dhe/ose përdorim të Bashkisë Berat ,sipas listës bashkëlidhur projekt-vendimit.
2. Qiraja do të realizohet për të tetë pasuritë,për një periudhë 2 (dy vjeçare).
- 3.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi , ngarkohet Drejtoria e Emergjencave , Pronave dhe Transportit.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ervin Ceca**

Lista e Pasurive me qira ne favor te Shetit Upstram (SUA)														
Nr	Bashkia	Njesia Administrative	Fshati	ZK	Nr. Parcele	Voli	Faqe	Lloji Pasurise	Pronar/Perdorues	Sip. Totale e Parcelas	Sip. Qira (m <sup>2</sup> )	Gjimi (lek/m <sup>2</sup> )	Vlera Qira Lek/Vit	Vlera Totale Lek (2 vit)
1	Berat	Single	Mbreshan	2634	349	7	241	Kullote	Bashkia Berat	1,262,244	246	128	31,488	62,976
2	Berat	Single	Mbreshan	2634	16/8			Kanal	Bashkia Berat	473	473	128	60,544	121,088
3	Berat	Single	Mbreshan	2634	17/2	1	85	Kullote	Bashkia Berat	10,000	11	128	1,408	2,816
4	Berat	Single	Mbreshan	2634	27/8	1	123	Rrugë	Bashkia Berat	5,950	175	600	105,000	210,000
5	Berat	Single	Mbreshan	2634	65	2	203	Rrugë	Bashkia Berat	38,700	1,672	600	1,003,200	2,006,400
6	Berat	Single	Mbreshan	2634	64/16	2	200	Kanal	Bashkia Berat	1,950	1,793	128	229,504	459,008
7	Berat	Single	Mbreshan	2634	64/18	2	202		Bashkia Berat	5,400	4,562	128	583,936	1,167,872
8	Berat	Single	Mbreshan	2635	16/27	7	122	Are	Bashkia Berat	570	570	128	72,960	145,920
	<b>Totali</b>									<b>9,502</b>	<b>9,502</b>		<b>2,088,040</b>	<b>4,176,080</b>